



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA VUSHTRRI – OPSTINA VUCITRN



Drejtoria për Prokurim Publik

Duke vendosur në çështjen administrative, sipas Kërkesës për Rishqyrtim të subjektit në procedurë: Grup i OE "As Tech" SHPK, me seli në Prishtinë, Autoriteti Kontraktues – Drejtoria për Prokurim Publik e Komunës së Vushtrrisë, pas mbajtjes së seancës jo publike të shqyrtimit të kërkesës të subjektit në fjalë, në bazë të nenit 108/A pika 6 lidhur me pikën 10 paragrafi 10.1 të Ligjit për Prokurimin Publik në Kosovë nr. 04/L-042 i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, me datën **12.10.2023**, merr këtë:

V E N D I M

1. **Refuzohet si e pabazë** Kërkesa për rishqyrtimin lidhur me Njoftimin Letër për Tenderuesin e pasuksesshëm, të subjektit në procedurë: Grup i OE "As Tech" SHPK, me seli në Prishtinë, në procedurën e prokurimit me titull: "Furnizimi dhe instalimi i paisjeve për klimatizim", Nr.Prokurimi: VU644-23-7744-1-2-1, Nr. i brendshëm: VU644-23-089-121.
2. **Vërtetohet si i bazuar** Vendimi i Autoritetit Kontraktues – Drejtorisë për Prokurim Publik për vazhdimin e aktivitetit në bazë të Njoftimit mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues të dt. **02.10.2023**.

A r s y e t i m

Autoriteti Kontraktues – Drejtoria për Prokurim Publik (në tekstin e mëtejme A.K.) në bazë të rezultatit nga procesi i ekzaminimit, vlerësimit dhe krahasimit të tenderëve ka marrë vendim që ta rekomandoj për dhënie të kontratës për aktivitetin: "Furnizimi dhe instalimi i paisjeve për klimatizim", OE "Adnani group" SHPK, me seli në Podujevë, ndërsa, O.E.: "As Tech" SHPK, me seli në Prishtinë, (në tekstin e mëtejme Ankuesin) ta radhit në mesin e O.E. të pasuksesshëm, bazuar në procedurën e zbatuar.

Njoftimi mbi Vendimin e A.K. si dhe Njoftimi letër për tenderuesin e eliminuar për Ankuesin janë dërguar për publikim në platformën elektronike më dt. **02.10.2023**, bazuar në dispozitat e Rregullores për Prokurimin Publik.

Në Kërkesën për rishqyrtim, Ankuesi konsideron se A.K. duke vendosur si në Vendimin e dt. **02.10.2023**, ka shkelur dispozitat e LPP-së, konkretisht: nenin 1; nenin 7; nenin 59; nenin 60 dhe nenin 69.

Ankuesi pretendon se:

Pretendimi i parë, se Autoriteti Kontraktues ka shpërblyer OE e papërgjegjshëm, pasi që OE i rekomanduar nuk i ka plotësuar kërkesat e Dosjes së Tenderit, si vijon: kapaciteti teknik dhe profesional – OE duhet të ketë të përmbushur furnizimet e natyrës së ngjashme në tri vitet e fundit nga data e publikimit të njoftimit të kontratës minimum me vlerë prej 47.000 €, dhe shtoi se OE në fjalë në listë të kontratave të dorëzuar ka

kontrata të ndryshme, por që nuk e plotësojnë kërkesën e dosjes, sepse nuk janë të natyrës së klimatizimit.

Pretendimi i dytë, OE në ofertë përveç që lista e tij nuk i përmbush kërkesat e AK, poashtu ka sjellë kontrata me blerës privat, që çdo kontratë e bërë mes dy palëve ka të njëjtën strukturë, ku dallon vetëm titulli ose të dhënat bazike, si dhe referencat që blerësit i kanë lëshuar për OE, të gjitha referencat nga blerësit kanë të njëjtën strukturë.

Lidhur me këto pretendime, **Autoriteti Kontraktues**, pasi që i shqyrtoj një nga një pretendimet e Ankuesit të parashtruara në Kërkesën për Rishqyrtim dhe vlerësimin të provave në shkresat e lëndës, gjeti se Kërkesa e Ankuesit **është E PABAZUAR** në tërësinë e saj, për arsye se:

Lidhur me pretendimin e parë, përgjigjen adekuate e ka dhënë KRPP në opinionin e saj të datës 09.06.2023, sipas të cilit është bërë dallimi në mes të shprehjeve “furnizime të ngjashme” dhe “furnizime të njëjta”. Në rastin tonë, referencat janë kërkuar për furnizime të ngjashme, e që është një pajtim të plotë me interpretimin e KRPP-së.


Lidhur me pretendimin e dytë, i njëjti është tërësisht i paqëndrueshëm, për faktin se OE e shpërblyer ka dëshmi të mjaftueshme dhe të besueshme (referenca dhe kontrata furnizimi), të cilat kanë të specifikuar emrin e blerësit dhe shumën, të cilat përmbushin vlerën e kërkuar, të përcaktuar në Dosjen e Tenderit.

Procedura është zhvilluar bazuar në dispozitat e Ligjit për Prokurimin Publik në Kosovë nr. 04/L-042 i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092. Neni 33 paragrafi 1 (Procedurë e Hapur) ka pasur për qëllim promovimin e transparencës, neni 60 paragrafi 1 pika 1.1 (tenderi i përgjegjshëm me çmimin më të ulët të peshuar) ka pasur për qëllim që bazuar në të gjeturat dhe rezultatet nga procesi i ekzaminimi dhe vlerësimi të tenderëve të vendosë për dhënie të kontratës O.E. me tenderin e përgjegjshëm me çmimin më të ulët. Mbi këtë bazë A.K. vlerëson se Vendimi i A.K. i dt. 02.10.2023 është marrë bazuar në kushtet, rregullat dhe procedurën e përcaktuar ligjore të LPP-së. Vendimi, sikurse ka vlerësuar A.K., është i mbështetur mbi baza ligjore e faktike, i pandikuar, që nuk diskriminon dhe që ka një transparencë të lartë të vendimmarrjes dhe po ashtu duke zbatuar kërkesat procedurale dhe qenësore të dispozitave të LPP-së.

Nga sa u tha me lartë, e në përputhje me nenin 108/A pika 10 paragrafi 10.1 të LPP-së A.K. vlerëson se pretendimet ankimore të Ankuesit janë plotësisht të paargumentuara dhe për rrjedhojë të pa bazuara, andaj A.K. konstaton se nuk ka asnjë arsye të vendosë ndryshme nga ajo që është thënë si më lartë, andaj u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Autoriteti Kontraktues – Drejtoria për Prokurim Publik
K.R. nr. 089/2023 - datë 07.10.2023

Drejtoria për Prokurim Publik


Alban Tahiraj - Drejtor

Vendimi i dërgohet:

1. 1x Palës,
2. 1 x DPP-së, dhe
3. 1 x Arkivit (1 kopje)